

SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Sh.a.

**Pasqyrat Financiare individuale sipas
Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

PËRMBAJTJE

Raporti i audituesit të pavarur	
Pasqyrat individuale e pozicionit financiar	1
Pasqyra individuale e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra individuale e ndryshimeve në kapital	3
Pasqyra individuale e flukseve të parasë	4
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare	
1. Informacion i përgjithshëm	5
2. Bazat e përgatitjes	6
3. Adoptimi i standardave dhe interpretimeve të reja dhe të rishikuara	6
4. Shpalljet e reja kontabël	6
5. Politika Kontabël të rëndësishme	9
6. Përdorimi i vlerësimeve dhe i gjykimeve	19
7. Menaxhimi i rrezikut financiar	19
8. Menaxhimi i rrezikut të sigurimit	24
9. Shënimet shpjeguese për përcaktimin e vlerës së drejtë	28
10. Aktive afatgjata materiale	30
11. Investime në filiale	30
12. Aktivitet e risigurimit	31
13. Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim	31
14. Të arkëtueshme nga sigurimet dhe të drejta të tjera sipas bilancit	32
15. Depozitat bankare me afat	33
16. Aktive të tjera	34
17. Mjete monetare dhe ekuivalente	34
18. Kapitali themeltar	34
19. Rezervat e rrezikut të sigurimit	35
21. Rezerva për prime të pafituara	36
22. Detyrime të tjera	36
23. Primet e shkruara bruto	36
24. Prime të ceduara të risiguresit	37
25. Të ardhura të tjera	37
26. Kostot e marrjes në sigurim	37
27. Shpenzime Administrative	37
28. Shpenzime të tjera sigurimi	38
29. Të ardhura nga investimet	38
30. Shpenzime të tatim fitimit	38
31. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara	39
32. Kompensimi i aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare	39
33. Shënimet shpjeguese për palet e lidhura	40
34. Ngjarje pas dates së raportimit	41
Raporte shtesë	
Marzhi i aftësisë paguese	i
Aktive për mbulimin e detyrimeve të sigurimit	ii



Raporti i Audituesit të Pavarur

Drejtuar Aksionarëve dhe Drejtimit të Sigal Uniqa Group Austria sh.a.

Raporti mbi auditimin e pasqyrave financiare

Opinionin ynë

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin, në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë, pozicionin financiar të Sigal Uniqa Group Austria sh.a. ("Shoqëria") më 31 dhjetor 2016, si dhe performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

Ne kemi audituar

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përfshijnë:

- pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2016;
- pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur në atë datë;
- pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në atë datë;
- pasqyra e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në atë datë; dhe
- shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, të cilat përfshijnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël.

Baza për opinionin

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"). Përgjegjësitë tona, sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin "Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare" në këtë raport.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar bazën e opinionit tonë.

Pavarësia

Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionin e Kontabilistit të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët ("kodi i BSNEK"), të cilat janë të zbatueshme në auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri. Ne kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin e BSNEK-së.

Përgjegjësitë e drejtimit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare

Drejtimi i Shoqërisë, është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF, dhe për kontrollin e brendshme, të cilat Drejtimi i gjykon të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo pasaktësive.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, Drejtimi i Shoqërisë është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të kryer veprimtarinë në vijimësi, duke vënë në dispozicion informacione për çështjet që kanë të bëjnë me vijueshmërinë e aktivitetit, nëse është e zbatueshme, përveç rasteve kur drejtimi synon ta likuidojë Shoqërinë apo të ndërpresë aktivitetin, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Personat e ngarkuar me qeverisjen e shoqërisë janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare në tërësi, nuk përmbajnë gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo të pasaktësive, dhe të lëshojmë një raport auditimi, duke përfshirë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk jep garanci

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k., Rr. Ibrahim Rugova, SkyTower, kati 9, Tiranë, Shqipëri
T: +355 (4) 2242 254, F: +355 (4) 2242 639, www.pwc.com/al

Raporti i Audituesit të Pavarur (vazhdim)

që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë, në rast se ekziston, një gabim material. Gabimet mund të vijnë si rezultat i mashtrimit apo pasaktësive dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht apo të marra së bashku, ekziston një pritshmëri e arsyeshme që të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Për më tepër, ne:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimit material në pasqyrat financiare, si rezultat i mashtrimit apo pasaktësisë, hartojmë dhe kryejmë procedura auditimi që i përgjigjen këtyre rreziqeve, si dhe sigurojmë të dhëna të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në mënyrë që të shërbejnë si bazë për opinionin tonë. Rreziku për të mos identifikuar një gabim material si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa një gabim si rezultat i pasaktësisë, për shkak se mashtrimi mund të përfshijë një marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosveprim të qëllimshëm, shtrembërim, ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- sigurojmë kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm të auditimit, me qëllim hartimin e procedurave të auditimit që u përshtaten rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionin mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël, si edhe shënimeve shpjeguese të përgatitura nga Drejtimi.
- japim përfundime mbi përshtatshmërinë e parimit kontabël të vijimësisë së veprimitarisë të përdorur nga Drejtimi dhe bazuar në evidencën e siguruar të auditimit, nëse ka një pasiguri të materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të ngjallin dyshime të rëndësishme në lidhje me aftësinë e shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Në rast se arrijmë në përfundimin që ekziston një pasiguri materiale, jemi të detyruar që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të audituesit në lidhje me shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare ose, në rast se shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencën e auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë të audituesit. Pavarësisht kësaj, ngjarje apo kushte në të ardhmen, mund të shkaktojnë ndërprerjen e vijimësisë së veprimitarisë së Shoqërisë.
- vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet në mënyrë të atillë që siguron paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Shoqërisë, ndërmjet të tjerash, në lidhje me qëllimin dhe afatet e planifikuara të auditimit si dhe gjetjet e rëndësishme të konstatuara nga audituesi, përfshirë mangësitë e rëndësishme në sistemin e kontrolleve të brendshme që identifikojmë gjatë auditimit tonë.

Raporti mbi kërkesat e tjera ligjore dhe rregullatore

Drejtimi është gjithashtu përgjegjës për përgatitjen e raporteve shtesë në lidhje me aftësinë paguese dhe aktivet në mbulim të rezervave teknike dhe matematikore në përputhje me rregulloret e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare ("AMF"). Këto raporte nuk janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare. Informacioni historik që paraqitet në këto raporte është i krahasueshëm me shumatat e paraqitura në pasqyrat financiare.

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k

5 maj 2017

Tiranë, Shqipëri



[Signature]
Jonida Lamllari
Auditues Ligjor


SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Sh.a.

Pasqyra individuale e pozicionit financiar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Aktive afatgjata materiale	10	734,140	784,850
Investime në filiale	11	2,018,150	2,040,041
Aktive të risigurimit	12	777,334	581,200
Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim	13	459,793	347,757
Llogari të arkëtueshme nga sigurimi	14	299,036	336,652
Depozita me afat me bankat	15	3,384,336	2,857,213
Aktive të tjera	16	252,524	175,258
Mjete monetare dhe ekuivalentë	17	117,128	149,481
TOTAL I AKTIVEVE		8,042,441	7,272,452
KAPITALI			
Kapitali themeltar	18	2,232,909	2,232,909
Rezerva nga konvertimi		(1,729)	(1,729)
Rezerva të rrezikut të sigurimit	19	262,225	262,225
Fitimi i mbartur		1,039,736	743,409
TOTAL I KAPITALIT		3,533,141	3,236,814
DETYRIMET			
Detyrime nga kontratat e sigurimeve	20	1,916,214	1,644,244
Rezerva për primet e paguara	21	2,116,182	1,927,686
Tatim fitimi i pagueshëm	30	28,603	12,353
Detyrime të tjera	22	448,301	451,355
TOTAL I DETYRIMEVE		4,509,300	4,035,638
TOTAL KAPITALIT DHE DETYRIMEVE		8,042,441	7,272,452

Këto pasqyra financiare individuale janë aprovuar nga Drejtuesit e Shoqërisë më 28 prill 2017 dhe janë firmosur nga:


 Avni Fonari
 Drejtor i përgjithshëm




 Klement Mersini
 Drejtor Finance

Shënimet nga faqja 5 në 41 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Sh.a.
Pasqyra individuale e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016	Viti i mbyllur 31 më dhjetor 2015
Prime të shkruara bruto	23	4,027,385	3,758,157
Prime të ceduara në risigurim	24	(697,113)	(525,264)
Ndryshimi në rezervat e primeve të pafituara	21	(188,496)	(282,285)
Ndryshimi në risigurim në rezervat e primeve të pafituara	21	74,713	(80,446)
Të ardhura neto nga primi i sigurimit		3,216,489	2,870,162
Të ardhura të tjera	25	82,482	81,074
Të ardhura neto		3,298,971	2,951,236
Ndryshimi në rezervat e dëmeve të sigurimit	20	(271,970)	(326,969)
Ndryshimi në rezervat e dëmeve të risigurimit	20	121,421	93,092
Dëme të paguara	20	(951,350)	(954,872)
Dëme të paguara nga risiguruesit	20	164,990	28,272
Dëme të sigurimit neto		(936,909)	(1,160,477)
Kostot e marrjes në sigurim	26	(805,800)	(651,048)
Shpenzime administrative	27	(984,807)	(846,435)
Shpenzime të tjera sigurimi	28	(92,545)	(153,970)
Çvlerësime në investimet e filialeve	11	(229,891)	-
Fitimi/(humbja) operative		249,019	139,306
Të ardhura nga investime	29	222,118	145,163
Fitime nga kursi këmbimit		(13,607)	74,140
		208,511	219,303
Fitimi para tatimit		457,530	358,609
Tatimi mbi fitimin	30	(91,333)	(62,912)
Fitimi i vitit		366,197	295,697
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse të vitit		366,197	295,697

SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Sh.a.

Pasqyra individuale e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

	Kapitali themeltar	Rezerva të rrezikut të sigurimit	Rezerva nga konvertimi	Fitimi i mbartur	Totali
Gjendja më 1 janar 2015	2,232,909	262,225	(1,729)	587,712	3,081,117
Fitimi i vitit	-	-	-	295,697	295,697
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	295,697	295,697
Dividendë të paguar	-	-	-	(140,000)	(140,000)
Balanca më 31 dhjetor 2015	2,232,909	262,225	(1,729)	743,409	3,236,814
Fitimi i vitit	-	-	-	366,197	366,197
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	366,197	366,197
Dividendë të paguar	-	-	-	(69,870)	(69,870)
Balanca më 31 dhjetor 2016	2,232,909	262,225	(1,729)	1,039,736	3,533,141

SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Sh.a.
Pasqyra individuale e flukseve të parasë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015
Flukset e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi para tatimit		457,530	358,609
<i>Rregullime për:</i>			
Amortizimi	10	67,811	66,345
Çvlerësime të investimeve në filiale		229,891	-
Fitimi nga shitja e aktiveve afat-gjata materiale		3,193	1,993
Të ardhura nga interesi		(26,504)	(27,691)
Të ardhura nga dividendët	29	(195,614)	(117,472)
Ndryshime në rezervat për primet e pafituara	14	106,572	173,579
Flukset e parasë nga aktivitetet operative para ndryshimeve në aktivet dhe detyrimet operative			
Ndryshime në aktivet e risigurimit		(196,134)	(12,646)
Ndryshime në llogari të arkëtueshme nga sigurimi		(68,956)	(238,336)
Rritje në kosto të shtyra të marrjes në sigurim		(112,036)	(99,438)
Ndryshime në aktivet e tjera		(77,266)	(22,182)
Ndryshime në detyrimet e kontratave të sigurimit		271,970	326,969
Ndryshime në rezervat për primet e pafituara (Zbritje)/rritje në detyrimet dhe provizioneve të tjera		(3,054)	69,215
Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative operations para interest dhe tatimit		645,899	761,230
Tatimi fitimi i paguar		(75,083)	(73,006)
Interesa të arkëtuara		27,659	25,136
Flukset neto të parasë nga aktivitetet operative		598,475	713,360
Flukset monetare nga aktivitetet investuese			
Blerje e aktiveve afat-gjata materiale	10	(22,650)	(41,064)
Të ardhura nga shitja e aktiveve afat-gjata materiale		2,356	4,579
Të ardhura neto nga depozitat me afat		(528,278)	(614,379)
Dividend të arkëtuar	29	195,614	117,472
Rritje në kapitalin e filialeve	11	(208,000)	-
Flukset neto të parasë të përdorura në aktivitetet investuese		(560,958)	(533,392)
Flukset monetare nga aktivitetet financuese			
Dividend të paguar		(69,870)	(140,000)
Flukset neto të parasë të përdorura në aktivitetet financuese		(69,870)	(140,000)
(Ulja)/rritja neto në mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre		(32,353)	39,967
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fillim të vitit		149,481	109,514
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fund të vitit	17	117,128	149,481

Shënimet nga faqja 5 në 41 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.